



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **ZYRA E PERSONELIT**

**Nr. 13-111-02-4131/19**

**Podujevë,**

**Më:18.01.2019**

Bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, Komuna e Podujevës shpallë :

# **K O N K U R S**

Për angazhimin e dy (2) Praktikantëve në Komunën e Podujevës për zbatimin e projektit "Ndërtimi i kapaciteteve të komunave të Kosovës në fushën e menaxhimit të energjisë komunale" të Asociacionit të Komunave të Kosovës mbështetur nga GIZ-i.

**DREJTORIA:** Drejtoria për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim

**POZITA :** Praktikant (2 pozita)

**KOHËZGJATJA:** 2 muaj

**ORARI I PUNËS :** 40 orë në javë

**MBIKËQYRËSI :** Menaxheri i Energjisë

### **Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të praktikantit do të jenë:**

Mbështesë menaxherin për energji në punën e tyre të perditshme, duke përfshirë:

- Futjen dhe procesimin e të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Energjisë;
- Mbështesë menaxherin komunal për energji në aktivitetet e ndërlidhura me procesimin e të dhënave për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë;
- Bashkëpunimi me departamentet përgjegjëse në komuna për të siguruar informacionin e kërkuar në lidhje me konsumin e energjisë në ndërtesat publike dhe ndriçimit rrugor;
- Mbështesë menaxherin për energji në përmbushjen e detyrave të tyre lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit të energjisë;
- Detyrat tjera sipas kërkesës/nevojës së paraqitur.

### **Kualifikimet, aftësitë dhe përvoja e kërkuar**

#### **Kualifikimet**

- Të ketë Diplomë pasuniversitare ose të paktën diplomë Bachelor në fushën e inxhinierisë apo fushat tjera të cilat ndërlidhen me objektivat e projektit/programit ( e preferueshme është fusha e inxhinierisë teknike dhe shkencat kompjuterike)

### **Përvoja**

- Përvoja paraprake në projekte në fushën e efijencies së energjise dhe ajo në mbledhjen dhe procesimin e të dhënave do të konsiderohet përparësi.

### **Njohuri /shkathtësi/pregatitje tjera**

- Njohuri të shkëlqyera në kompjuter, shkrim, komunikim dhe aftësi prezentimi;
- Të jetë i/e mirë organizuar;
- Të ketë aftësi hulumtuese;
- Të ketë aftësi për të punuar në grup;
- Te jete i gatshem të marrë pergjegjesi të tjera, gjithmonë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e fushëveprimit;
- Te ketë njohuri të mira të gjuhës angleze dhe gjuhëve kombëtare.

### **Lokacioni**

- Zyret do të jenë të vendosura në komunat përkatëse

### **Kohëzgjatja**

- Praktika do të zgjasë dy muaj
- Praktika është me orar të plotë (8 orë në ditë, 40 orë në javë)

### **Pagesa**

- Pagesa për praktikantët do të jetë 200 euro bruto në muaj (përfshirë të gjitha taksat e aplikueshme në Kosovë)

### **Dokumentet e doemosdoshme për Aplikim:**

- Kopjen e letërnjoftimit
- Diplomen e fakultetit te kryer të nivelit përkatës
- Dëshmitë për përvojë pune ose trajnime përkatëse
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime
- Cv dhe Letrën Motivuese

## INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDITATËT

**Data e shpalljes së Konkursit: 18.01.2019 deri më 25.01.2019**

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në tabelën e shpalljeve.

AKK-ja mbështetur nga GIZ do të kujdesën që kandidatët të përmbushin kriteret për t'u kontraktuar nga AKK-ja, sipas fushëveprimit dhe kushteve të specifikuara.

**U.D i Udhëheqësit të Personelit**



**Blerim Nishevc**